



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E GARËS**  
**KOMBËTARE TË ROBOTIKËS**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës, për vitin shkollor 2023/2024.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 20.000,00 € (njëzet mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për Fondacionin "Unë e du Kosovën", për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës për vitin shkollor 2023/2024 .

**IV.**

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e Fondacionit "Unë e du Kosovën".

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**VI.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-400/01-215649/23, më 03.11.2023**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Pëllumb Bajcinovci**

